



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren
Prizren Belediyesi

**Procesverbali për mbajtjen e dëgjimit publik për buxhetin e vitit 2026 i
organizuar nga anëtarët e KPF-së**

Publikimet:

Me 01.08.2025, janë publikuar dokumentet në web, platformë dhe në rrjetin social facebook.

Njoftimi në web:

<https://prizren.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/09/Njoftim-per-organizimin-e-degjimit-publik-per-buxhetin-e-vitit-2026-dhe-vitet-2027-2028-KPF.pdf>

Njoftimi në platformë:

<https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42901>

Njoftimi si lajmi në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/news/njoftim-per-organizimin-e-degjimit-publik-per-buxhetin-e-vitit-2026-dhe-vitet-2027-2028-kpf/>

Me 29.08.2025 është publikuar projekt Buxheti:

<https://prizren.rks-gov.net/degjimet-buxhetore/?tax=projekt-buxheti>

Me 01.08.2025 janë publikuar raportet për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore: <https://prizren.rks-gov.net/degjimet-buxhetore/?tax=projekt-buxheti>

Ky procesverbal është përgatitur duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna me theks neni 30-Mbledhja e komenteve, komunikimi dhe adresimi i tyre.

Me 10.03.2025, kryetari i komunës së Prizrenit Shaqir Totaj, ka nënshkruar vendimin për formimin e grupit punues për përgatitjen e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) për vitet 2026-2028 si dhe Projekt Buxhetin e Komunës së Prizrenit për vitin 2026. Përbërja e këtij grupi është: Lulzim Sylejmani, kryesues i grupit; Halil Lika, zëvendës kryesues; Gjafer Ponik, anëtar-procesmbajtës; Ymer Berisha, anëtar; Fejsal Hoti, anëtar; Besarta Caka, anëtare Shaban Krasniqi, anëtar ; Fisnik Minci anëtar (OJQ) dhe Haziz Krasniqi, anëtar.

Procesverbali:

Dëgjimi ka nisur në orën : 10:15

Ymer Berisha, udhëheqësi i Njesisë për Komunikim me Publikun, i cili ka thënë se dhe sot sikur se edhe në dëgjimet tjera që mbajtura ne do ti dëgjojmë kërkesat tuaja që i keni dhe më pas ato kërkesa sipas prioriteteve do të hynë në buxhetin e vitit 2026, qytetarët që janë të pranishëm në dëgjim dhe kërkesat i kanë bërë gjatë dëgjimit në lokalitetet ku janë mbajtur dëgjimet, ju lus që të mos i përsëritini, përpos nëse keni kërkesa të reja.

Siç edhe e dini ky dokument-buxheti i komunës është pothuajse dokumenti kryesor i cili miratohet këtu në këtë sallë nga anëtarët e të gjitha partive politike që janë të përfaqësuara, kërkesat tuaja do të hyjnë në buxhet duke u bazuar edhe në prioritete.

Antigona Berisha Bytyqi, Kryesuese e Kuvendit Komunal ka përshëndeti dhe falënderoj kryetarët e lagjeve dhe fshatrave për praninë e tyre dhe për kontributin e dhënë gjatë gjithë procesit të dëgjimeve buxhetore.

Për mbajtjen e këtij dëgjimi publik zyrtarët përgjegjës do të mbajnë procesverbal dhe to të hartojnë raport me të gjitha detajet. Gjithashtu Kryesuesja Berisha-Bytyqi ka thënë se ky dëgjim buxhetorë po mbahet pas përfundimit të të gjitha procedurave ligjore dhe pranimi të buxhetit nga ana e kryetarit të komunës Shaqir Totaj.

Kërkesat e qytetarëve të pranura gjatë dëgjimit publik:

Bashkim Gashi-Kërkoj formimin e dy muzeve:

Objekti i ish burgut të bëhet muze dhe

Ndërtesa e pare e pastës të shpallet muze

Faik Berisha

Mirëmbajta apo pastrimi I shtratit te lumit ne fshatin Landovic

Rregullimi i rrugës ne hyrja te fshatit

Bujar Pulaj

Ndërtimi i rezervarit për ujë te pijshëm

Vendosja e ujëmatësve sikur që janë vendosur në fshatin Zhur

Almir Bajrami

Rregullimi dhe mirëmbajtja e Ambulantëve ne fshatrat e Zhupes

Agron Halimaj

Ndërtimi I kanalizimit në fshatin Poslisht

Dëgjimi ka përfunduar në orën:10:40

Procesmbajtës:

Gjafer Ponik

Haziz Krasniqi